

Ne fokus/ Derbi kryqytetit sfidon Shqiperi-Zvicer

nga AlbaniaSoccer

E premte, 11 Tetor 2013 17:38



Interesimi per ndeshjen Shqiperi-Zvicer ka qene shume i madh por me i madh duket se eshte interesimi per nje tjetere ndeshje. Derbi i munguar per disa vite mes Partizanit dhe Tiranës ka sfiduar ndeshjen e kombetares. Shume bileta te shitura ne pak ore dhe shume kerkesa nga te dy tifozerite qe pritet te dhurojne spektakel ne shkallet e Qemal Stafes. Kombetarja e ka ndjere keto dite kete ndryshim pasi si rralle here para ndeshjeve te tilla, skuadra kuqezi nuk ka qene ne qender te vemendjes.